



AKTIVITETE PËRGATITORE PËR SIMULIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

14.06






Praktikantët e angazhuar në projektin "Rritja e transparencës dhe sundimit të ligjit në komunitetet me shumicë serbe në Kosovë" kanë kryer aktivitete përgatitore dhe përgatitën një lëndë për një simulim të procesit gjyqësor, i cili do të organizohet më 30 qershor 2021, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë. Aktivitetet për simulimin gjyqësor u mbajtën më 7, 14 dhe 29 qershor 2021.

Simulimi i procesit gjyqësor u zhvillua nga OJQ ACDC në bashkëpunim me OJQ AKTIV, dhe projekti është financuar nga INL Kosovë.



KONFERENCA "PJESËMARRJA E AVOKATËVE TË RINJ NË INSTITUCIONET GJYQËSORE NË KOSOVË"

16.06



Avokatët e rinj patën mundësinë të ndajnë përvojat dhe njohuritë e tyre të fituara nga puna në institucionet gjyqësore. Gjithashtu, avokatët e rinj prezantuan problemet me të cilat përballen profesionistët e tyre dhe sfidat me të cilat përballen pas diplomimit, praktikës dhe kalimit të provimit të jurisprudence.

Më 16 qershor, OJQ Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike organizoi një konferencë të titulluar "Pjesëmarrja e avokatëve të rinj në institucionet gjyqësore në Kosovë". Panelistët në konferencë ishin avokatë të rinj nga veriu i Kosovës, znj. Nina Virijević, avokate nga Leosavic, znj. Teodora Taniq, avokate nga Mitrovica e Veriut, znj. Sandra Spasojeviq, avokate nga Mitrovica e Veriut, znj. Ljiljana Petronijević, avokat nga Zubin Potok dhe z. Andrija Milisavljeviq, avokat nga Zveçani.

Konferenca është pjesë e projektit "Rritja e transparencës dhe sundimit të ligjit në komunitetet me shumicë serbe në Kosovë", financuar nga INL, dhe implementuar nga OJQ ACDC në partneritet me OJQ AKTIV.

SHKOLLA PËR TË DREJTAT E NJERIUT, NATË FILMI

17.06



Të enjten, më 17 qershor, Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike organizoi një mbrëmje filmi, ku morën pjesë pjesëmarrës nga Shkolla e të Drejtave të Njeriut. Mbrëmja e filmit u organizua në ambientet e Qendrës Avokuese për Kulturë Demokratike, ku pas filmit, u organizua një aheng i shoqëruar me koktej rasti.





KONFERENCA "TË DREJTAT PRONËSORE NË KOSOVË"

18.06

Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (OJQ ACDC) dhe Qendra për Dialog Social dhe Nismat Rajonale (CSDRI) më 18 Qershor 2021, organizuan konferencën me titull "Të Drejtat Pronësore në Kosovë". Problemet me të cilat përballet popullata Serbe në Kosovë dhe të ushtronin të drejtës së tyre pronësore ishte fokusi kryesor i panelit, ku u shpjeguan mënyrat dhe mekanizmat për të arritur të njëjtën gjë, duke përdorur mjetet ligjore në dispozicion.

Panelistët në konferencë ishin Z. Igor Popović - Sektori për Mbrojtjen Ligjore, Mbështetje të Vetëqeverisjes Lokale dhe Çështjet Pronësore-Ligjore në Kosovë, Ndihmës Drejtori, Zyra për Kosovë dhe Metohi dhe Z. Milan Antonijević - Ekspert Ligjor.



SIMULIMI I PROCESIT GJYQËSOR

30.06



Në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, më 30 qershor, pas disa javësh përgatitje, praktikantët zhvilluan me sukses simulimin e procesit gjyqësor në kuadër të projektit "Rritja e transparencës dhe sundimit të ligjit në komunitetet me shumicë serbe në Kosovë". Simulimi u mbajt në lëndën e vrasjes në tentativë, të cilën ata e zgjidhën lehtësisht duke përdorur të gjitha burimet ligjore në dispozicion. Shkathtësia e tyre në rolet e gjyqtarëve, trupit gjykues, avokatëve, dëshmitarëve vlerësohet si e pa të metë. Simulimi i gjykimit u përgatit me ndihmën e gjyqtarëve nga Gjykata Themelore në Mitrovicë.

SHKOLLA PËR TË DREJTAT E NJERIUT, LIGJERATË



Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike dhe Këshilli i Evropës organizuan një ligjeratë të hapur me temë "Hyrje në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut", si pjesë e projektit "Programi Edukativ i Shkollës për të Drejtat e Njeriut - Të Drejtat e Njeriut në Horizont". Ligjerata u drejtua nga Profesor Kanstantsin Dzehtsiarou nga Universiteti i Liverpool. Projekti mbështetet nga CDF.